

S Q A R U E S

Mbi mbylljen e llogarive financiare të Ujësjiellës Kanalizime Pukë Sh.A Për periudhën ushtrimore 01 Janar deri 31 Dhjetor 2019

A .INFORMACION I PERGJITHSHEM DHE POLITIKAT KONTABEL

Ndermarrja Ujesjelles Kanalizime Bashkia Pukë është krijuar me daten 19.03.2008 sipas Vendimit Keshillit Bashkiak Nr 5 datë 19.03.2008,në zbatim të vendimit të Gjykeses së Tiranës nr.26852/1,date 01.02.2005,me seli në qytetin e Pukës, ka ushtruar aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë sipas **Licenses nr. 01 Vendimi nr. 03 dt. 18.01.2010** të lëshuar nga **ERRU**-ja Tiranë, për ushtrimin e këtij aktiviteti.

- Bazuar në VKM nr.173 date 26.03.2004 "Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujesjelles –kanalizimeve në pronësi të njesive të qeverisjes vendore",si dhe vendimit të VKM nr.63 date 27.01.2016"Per riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,grumbullimin,largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura" Ndermarrja e Ujesjelles-Kanalizime Bashkia Puke me numer nipti K79121308S dhe Ndermarrja Ujesjelles-Kanalizime Sh.A Puke Fshat me numer nipti J69310307F u transferuan në Ujesjelles-Kanalizime Puke Sh.A Puke me numer nipti J69310307F sipas ekstraktit historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit"Shoqëri Aksionere" me objekt aktiviteti:Shërbim Furnizimi me ujë të pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij;Mirembajtja e sistemit /sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm ; Prodhimi dhe /ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatoreve;Shërbimi i grumbullimit,largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura;Mirembajtja e sistemeve të ujrave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Sipas procedurave për emërimin e ekspertit kontabel, z.Lulash Pjeternikaj, për përgatitjen e raportit të zmadhimit të kapitalit date 10.04.2018 Vendimi i aksionerit të vetëm Nr.9 date 23.04.2018 për miratimin e raportit të ekspertit për zmadhim kapitali aksioner me kontribute në natyrë nepërmjet transferimit të aktivitetit ,aktiveve detyrimeve dhe kapitaleve nga Ndermarrja Ujesjelles-Kanalizime Bashkia Puke duke kaluar në UJESJELLES-KANALIZIME Sh.a Puke.

Kapitali i shoqërisë pas këtij zmadhimi bëhet 143.651.000 leke e ndarë në 143.651 aksione në vlerë nominale 1000leke/aksioni.

Vlera e kapitalit ishte 134.701.000 u bë 143.651.000 leke

Numri i aksioneve ishte 134.701 u bë 143.651 aksione.

Në vitin 2019 është bërë zmadhim kapitali ku kapitali I shoqërisë bëhet 246 050 000 leke e ndarë në 246 050 aksione me vlerë nominale 1000 leke/aksione të

Ujësjiellës Kanalizime Pukë Sh.A, si dhe Vendimit të Gjykeses së Tiranës nr.26852/1,date 01.02.2005 për zvogëlimin e kapitaleve të sh.a. Ujësjiellës Kanalizimeve Pukë, janë baza ligjore për hartimin e këtij akt-dorëzimi dhe krijimin e ndermarrjes së re.

Rezervat të tjera mbeten 553 leke.

Në zmadhimin e këtij kapitali është përfshirë objekti:Furnizim me ujë qyteti Puke,Rrjeti I jashtëm dhe I brendshëm,ndërtuar me fonde nga buxheti I shtetit gjatë viteve 2009-2014.

- Gjithashtu krijimi i ndermarrjes bazohet edhe në materialet e grupit të punës (me ekspert të Bashkisë Pukë dhe të sh.a.Ujësjiellës KanalizimePukë) i ngritur për verifikimin faktik dhe marrjen në dorëzim të objekteve të sistemit nr.1 nga Bashkia Pukë.

- Bazuar në VKM nr.173 dt.26.03.2004 Ujesjelles Kanalizime Bashkia Pukë nuk ka asnjë të drejtë mbi detyrimet debitore e kreditore, ku në këto llogari, ajo ka marrë gjendjen zero .

- Sa i takon sistemit të kanalizimeve të ujrave të ndotura, në VKM nr.173,date 26.03.2004 "Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të kanalizimeve ,në pronësi të njesive të qeverisjes vendore",për rrethin Pukë, nuk është e përfshirë kalimi i tij, për pasojë,ky i jepet Bashkisë në dorëzim, pasi është brenda territorit të saj.

1. Kjo ndermarrje e ushtron aktivitetin e saj ekonomik në përputhje me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërit tregtare" dhe me statusin e saj.
- Kapitali themeltar (i nënshkruar) është 143,651,000 lekë në çelje dhe me datën 31.12.2017 .
- Administratori i Ndermarrjes Ujesjelles Kanalizime Bashkia Puke është z.Petrit Dedaj me emrim nga Kryetari i Asamblese dhe drejtues ligjor me vendim të ERRU Tiranë sipas vendimit të përmendur më lart;
- Selia e Ujesjelles-Kanalizime Pukë Sh.A është në qytetin e Pukes;
- Është e regjistruar pranë organeve Tatimore në qytetin e Pukes me nr. NIPTI-i të kesaj ndermarrje J 69310307 F
- Numri i llogarise 002087339 pranë deges Raiffeisen Bank Dega Pukë
- Objekti i veprimtarise së Ndermarrjes Ujesjelles Kanalizime Bashkia Pukë është **Kategoria A-**. Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe **Kategoria C** – Për largimin e ujrave të ndotura, këto të përcaktuara në Liçencën e marrë nga ERRU;
- Ujesjelles Kanalizime Pukë Sh.A ka një personel prej 28 punonjës nga të cilët 1 (një) person është drejtues.
- Sipas statutit aktiviteti i ndermarrjes do të zgjasë për një periudhë kohore prej 10 vitesh.

Politikat Kontabël.

Mbajtja e kontabilitetit e përgatitja e pasqyrave financiare të shoqërisë është bërë në përputhje me parimet bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “ Për kontabilitetin e pasqyrat financiare “ i ndryshuar dhe me standartet kombëtare të kontabilitetit (SKK).

Parimet bazë që janë zbatuar për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare , kan qenë :

1. Parimi mbi bazën e të drejtave e detyrimeve të konstatuara. Transaksionet e ngjarjet e tjera ekonomike, janë njohur në pasqyrat financiare, kur ato kanë ndodhur, ndërsa shpenzimet janë njohur në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat që lidhen me to.
2. Parimi i njësisë ekonomike. Në pasqyrat financiare janë regjistruar aktivet, pasivet, kapitali, të ardhurat e shpenzimet, fluksi i parave, që i përkasin njësisë ekonomike.
3. Parimi moskompesimit. Shoqëria me përjashtim të kompesimeve që lejon SKK-ja, nuk ka bërë kompesime midis aktiveve e pasiveve, të ardhurave e shpenzimeve.
4. Është respektuar parimi i përgatitjes së pasqyrave financiare mbi bazën e kostos historike. Shoqëria ka ndërtuar një plan të llogarive vetjake, në përputhje me listën e llogarive të miratuar nga SKK-ja. Ekziston një ndarje e detyrave midis personave që kanë përgjegjësi materiale e autorizuesve kryesor të veprimeve.

Kontabiliteti mbahet i informatizuar. Ka organizuar e mban edhe kontabilitetin analitik, në funksion të nevojave të kontrollit, të performancës e kontrollit të analizave të brendëshme.

Çdo veprim apo ngjarje ekonomike është e mbështetur në dokumenta ligjore justifikuese. Regjistrimet janë bërë në mënyrë kronologjike e sistematike. Metoda bazë e mbajtjes së kontabilitetit është regjistrimi dyfishtë. Të paktën një herë në vit është bërë vlerësimi i ekzistencës së elementëve të Aktivit e Pasivit të bilancit.

B. Shënimet që shpjegojnë postet e pasqyrave financiare.

1. Rregullat e vlerësimit të Aktiveve Monetare.

1/1 apo Shuma e Aktiveve Monetare në fillim të periudhës gjithsej është 301.491 leke

-512 “Banka llogari likujduese është me gjendje në fund të periudhës ushtrimore me mbetje debitoare në lek 77,200 lekë .

-531 Arka 0 leke së cilës i korespondon në këtë bilanc stratoja e bankës dhe të arkës dt. 31.12.2019 bashkalidhur këtij bilanci.

2. Rregullat e vlerësimit të Aktiveve të tjera financiare Afatshkurtër paraqitet me këtë gjendje

:

2/1 “kërkesa të arkëtueshme“ në total është 16,764,232 leke nga e cila :

- Kërkesa të arkëtueshme mbi debitorët 16,764,232 leke e cila i korespondon analizës analitike të këtij bilanci bashkelidhur, të debitorëve në fund të periudhës ushtrimore detajuar sipas muajve të detyrimit mbetur dhe në persona e institucione shtetërore a lokale private.

- 3. Rregullat e vlerësimit të inventarit.

3/1 apo “Lëndët e para “ paraqiten me gjendje në fund të periudhës ne Shumen 2.361.356 leke . Gjendja e tepricës debitoare e llogarisë “ 312 “ është 2.231.656 lekë llogaria “327 “ është 129.700 lekë në fund të periudhës ushtrimore. Për analizën e detajuar të kësaj llogarie është fletë inventari bashkelidhur këtij bilanci .

4. Rregullat e vlerësimit të aktiveve materiale afatgjatë.

në total per vlerë neto është 1.216.493 leke llog 218

5. Huatë e Parapagimet

Në pasqyrën “DETYRIME DHE KAPITALI “ HUATË DHE PARAPAGIMET:

Totali i detyrimeve afatshkurtra është 14,565,275 leke e ndarë si më poshtë :

Nga te cilat per Ujesjellesin Puke Sh.A detyrimet jane si me poshte:

- Sa i takon llogarisë kontabile 401 “ Furnitor e sipërmarrës “ paraqitet me gjendje kreditore në vlerën 895,374 leke e cila pasqyron detyrimet tona të papaguara ndaj Furniturave te ndryshme ne sherbim te insitucionit dhe mirembajtjes se rrjetit . Për të gjitha këto jemi bazuar në pasqyrimin në bilanc sipas SKK e cila tregon me vërtetësi tepricen kreditore të detyrimeve tona afatshkurtra.
- Paga punonjesish 3 548 740 leke.
- Shperblim Keshilli Administrimit 28.900 leke
- Sigurime shoqerore 1 379.390 leke.
- Gjoba dhe penalitete tatimore 1 284 969 leke.
- Tatim page 58 520 leke.
- Tatim burim 169 169 leke
- Tvsh 3 098.252 leke
- Tatim Fitimi 258.818 leke.
- Tarife Agjensia Baseneve 255 820 leke
- Energji elektrike 14 606 leke.
- Shpenzime telefonike 24500 leke
- Sherbime postare 2 840 leke.
- Sherbime transporti 171 500 leke.
- Sherbim internet 7 200 leke.
- Dru zjarri 56 700 leke.
- Blerje materiale hidraulike 110 388 leke.
- Vendim Gjygsor 3 669 963 leke.
- Tarife Basene 425 000 leke

6. Kapitali aksioner

Sipas përcaktimit të bërë në SKK kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 , njësia jonë ekonomike, ka pasqyruar realisht kapitalin që është aksioner i vetëm Bashkia Pukë dhe askush tjetër dhe është e pasqyruar në bilanc në shumën 246,050,000 lek (kapitali aksionar) në mbyllje të ushtrimit.

7. Humbjet e vitit finaciari 2019

Në këtë zë është paraqitur rezultati periudhës ushtrimore të njësisë sonë raportuese për periudhën ushtrimore 01.01.2019 - 31.12.2019, ashtu siç rezulton nga pasqyrat e të ardhurave e shpenzimeve.

8. Rezultati Ushtrimor është – 4.313.561 lek).Bashkimi I dy ujesjellesave e ka rritur humbjen kjo ndikon ne rezultat nga humbjet e mbartura dhe rritja e shpenzimeve dhe te ardhurat nuk e mbulojne koston.

8/1 Të Ardhurat

Llog. 701 - 705

Në pasqyrën e të ardhurave kemi pasqyruar (gjendjen ne fillim te periudhes 301491 leke) shumën e të ardhurave neto nga shitjet për ujë të pijshëm nga popullata,subjekte private ,e insitucione shtetore shërbime të tjera te vitit 2019 te Ujesjellesit Puke dhe njesite administrative Gjegjan,Qelez,Luf-Qerret).Jane subvensionuar nga AKUK 595 mije leke e ndare si me poshte:

- Per sigurime shoqerore 196 000 leke
- Inv Sistemim me matje abonente familjar dhe jofamiljar 399 000 leke+52354 leke me fonde te ujesjellesit Puke.

8/2 Shpenzimet

- **Kostot e punes llogaria (641,648,641,644)** që janë në vlerën e përlllogaritur 13.278.414 lek e ndarë :

1. Paga personeli	9,625,913, lek
2. Sig. Shoq.	3.076.988, “
3. Tatim page	291.553 “
4. Te tjera ndalesa ne page	283.960 “

- Shpenzime të tjera : = 1,884,486 lekë të detajuara si më poshtë

Amortizime Zhvlerësime llog.68 = 2,852,974 e detajuar si vijon :

1. “Toka”	0
2. “ Ndërtesa “	668,409 lek
3. “ Linja uj.k. “	2 083,966 “
4. “ Inst. Tek.”	44,618 “
5. “ Paisje ek. “	56,081 “

Amortizimi është përlllogaritur në pasqyrat e amortizimit për çdo zë në regjistrat e kontabilitetit sipas SKK 2, sipas ligjit 8438 datë 28,12,1999 për tatimin mbi vlerën e shtuar e ndryshuar sipas viteve, por nuk ka ndryshime për vitin 2019.

Shpenzimet e vitit 2019 1,884,486 leke

1. Energji Elektrike	59,422 leke
2. Postare	17,855 “
3. Transporte	199,000 “
4. Djetë	336,600 “
5. Vendime Gjygsore	1,749,963 “
6. Sherbim Interneti	16,800 “
7. Riparime dhe sherbime	50,420 “
11. Sherbime te tjera	1 201,389 “

Shpenzimet e vitit 2019 per Furniturat 1369.008 leke .

1. Kancelari	108.840 “
2. Boje printeri	119.880 “
3. Blerje Vegla Pune	381.600 “

- | | |
|--|-----------|
| 4. Blerje materiale hidraulike dhe KUZ | 592,548 " |
| 5. Klor per dezenfektim uji pijshem | 109.440 " |
| 6. Dru Zjarri | 56. 700 |

Ky bilanc eshte hartuar per Ujesjelles-Kanalizime Puke Sh.a per periudhen ushtrimore 01.01.2019-31.12.2019 (shesat dhe pakesimet) dhe mbartjet e bilancit te reformuar te dates 31.12.2018 ku jane bashkuar te dyja ndermarrjet Ujesjelles-Kanalizime Sh.A Fshat dhe Ujesjelles-Kanalizime Bashkia Puke .

Pasqyrat financiare të paraqitura në këtë bilanc, paraqesin një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar , përformancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë sonë ekonomike , pasi këto paraqesin në mënyrë të saktë e plotë përmbajtjen e ngjarjeve ekonomike, ka vlerësime të arësyeshme e të bazuara dhe të dhënat janë pregatitur me detaje sipas pozicionit financiar etj.

Në përgatitjen e nxjerrjen e të dhënave të këtij bilanci, pra të nxjerrjes së llogarive vjetore, çdo e dhënë e pasqyrim në të është bërë mbi bazën e kërkesave të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Kontrabilitetit si dhe të objektivave kryesore të KKK –së .

Pasqyrat janë pregatitur mbi bazën e materialit. Ne kemi zbatuar parimin e vijimësisë së paraqitjes së pasqyrave financiare, të kuptueshmërisë së tyre, besueshmërisë duke qenë një informacion i paanshëm e nuk ka gabime materiale dhe është një prezantim besnik për të gjithë të dhënat a transaksionet e kryera materiale e financiare, mbi bazën ligjore të nxjerrjes së të dhënave e pasqyrave, por edhe të argumentimit në detaje me analizën e të gjithë të dhënave në këtë bilanc, qoftë për detyrimet e të ardhurat.

Mbështetja e plotë në SKK dhe të SNK e pasqyrave të miratuara nga KKK për paraqitjen e pasyrave financiare (PF) për v. 2019, na ka mundësuar saktësinë e të dhënave dhe PF që ne kemi pregatitur.Bilanci eshte pare tek eksperti kontabel, per tu konfirmuar .

Pergj.Sek Ekonomik

Lavdie Terbuni




Direktori

Përm. Dedaj

